



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më 22/05/2007

Drejtuar: KOMISIONIT PËR EDUKIMIN DHE MJETET E  
INFORMIMIT PUBLIK  
KUVENDI I SHQIPËRISË

TIRANË

Lënda: Dërgohen mendime për një projektligj

E nderuar znj. Kryetare e Komisionit!

Të nderuar Antarë të Komisionit!

1. Së pari, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson adresimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetete e Informimit Publik për dhënie sugjerimesh për projektligjin "Për trasmetimet numerike eksperimentale në Republikën e Shqipërisë", pas marrjes së komenteve dhe analizës Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës mbi këtë draft.

2. Duke marrë në konsideratë që tregu i medias audiovizuale mbetet një treg i rregulluar dhe i monitoruar, Autoriteti i Konkurrencës do të dëshironte të jepte komentet për projektligjin pas dhënies së mendimeve nga institucionet relevante si KKRT dhe ERT.

Gjithësesi, me gjithë kohën e shkurtër në dispozicion, lutem gjeni si vijon mendimet e Autoritetit të Konkurrencës:

### I. NË PARIM

3. Parë në këndvështrimin e ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" dhe rekomandimeve të Komisionit Evropian, për zbatimin e rregullave të konkurrencës në fushën e medias<sup>1</sup>, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se fryma e projektligjit duhet të

---

<sup>1</sup> The application of competition and anti-trust policy in media (autor: Jean François Pons)

bazohet në parimin për hapjen e tregut ndaj konkurrencës dhe ndalimin e zgjerimit të barrierave të hyrjes apo mbylljen e tregut për konkurrencë.

4. Gjithashtu, duhet të mbahet parasysh që konkurrenca në tregun e trasmetimeve numerike me pagesë mund të preket nga çështje të sjelljes antikonkurruese të operatorëve në treg si abuzimi me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara dhe përqëndrimet (bashkimet, fitimi i kontrollit apo krijimi i Joint-venture) që bëjnë operatorët me njëri-tjetrin (horizontale ose vertikale). Të gjitha këto ndryshime në treg duhet<sup>2</sup> të marrin miratimin e Autoritetit të Konkurrencës, sipas kriterëve të ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

## II. VLERËSIME TË DETAJUARA

5. Sugjerimi i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës është marrja në konsideratë e opinionit të Autoritetit të Konkurrencës për nenin ku flitet për pluralizmin në median audiovizuale.

6. Në nenin "Pluralizmi në median audiovizuale", propozojmë të fillohet me paragrafin e nocionit të pluralizmit të medias që i tejkalon kufijtë e pronësisë së medias; ai mbulon aksesin në informacione të larmishme në mënyrë që shtetasit të krijojnë opinione pa u influencuar nga një burim (mediatik) dominues. Qytetarët kanë nevojë gjithashtu për një mekanizëm transparent që i garanton se media që po shohin është realisht e pavarur.

7. Sigurisht që mbështesim opinionin e BE-së dhe KE-së se pa patur një ide të numrit të mundshëm të rrjeteve tokësore dixhitale, licensat e mundshme, spektrit të frekuencave të disponueshme dhe barrierat tjera teknike ose jo teknike të tregut, nuk mund të jepet një vlerësim mbi nivelin e konkurrencës në këtë treg dhe deformimet potenciale që mund të vijnë operatorët e tregut.

8. Në varësi të këtyre hapësirave dhe/ose kufizimeve të tregut mund të ketë dhe përcaktime të numrit të licensave duke marrë në konsideratë ligjin 8410<sup>3</sup>.

---

<sup>2</sup> Mbetet në çmimin e Kuvendit nëse kjo pikë shtohet në nenin 13, Pluralizmi në Media ose nënkuptohet se edhe ky treg do të rregullohet nga ligji i Konkurrencës, që ka hyrë në fuqi para këtij ligji.

<sup>3</sup> datë 30.9.1998, PËR RADION DHE TELEVISIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË (ndryshuar me ligjin nr. 8655, datë 31.07.2000, me ligjin nr. 8794, datë 10.05.2001, me ligjin nr.9016, datë 20.2.2003, me ligjin nr.9124, datë 29.07.2003 dhe me ligjin 9531, datë 11.05.2006)

9. Sa i përket pikës së fundit të këtij neni, zotërimi i një pjesë të caktuar të përqindjes së reklamës<sup>4</sup>, thënë ndryshe pasja e një pozicioni dominues në treg të një operatori të vetëm ose disa operatorëve, nuk është e ndaluar<sup>5</sup> nga ligji 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe nga legjislacioni shqiptar në këtë fushë. Ndaj dhe mendojmë që mund të hiqet si nënpikë e nenit Për pluralizmin në media.

10. Si konkluzion, opinioni i Autoritetit të Konkurrencës është se Konkurrenca<sup>6</sup> mund dhe duhet të luajë një rol të rëndësishëm në këtë sektor, nëpërmjet zbatimit të ligjit për eliminimin e kufizimeve të konkurrencës (si p.sh marrëveshjet e fiksimit të çmimit ose kartelet mes konkurrentëve) dhe abuzimi me pozitën dominuese që mund të zotërojë një firmë në treg. Së dyti, ligji duhet të sigurojë që procedura e përqendrimeve të operatorëve në treg duhet të kalojë në sitën e Autoritetit të Konkurrencës për të parë efektivitetin që sjellin në konkurrencë ose për të ndaluar krijimin apo forcimin e pozitës dominuese në treg.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Lindita MILO(LATI)**

---

**KRYETAR**

---

<sup>4</sup> Sipas projektligjit asnjë operator nuk mund të zotërojë më shumë se 30 % të reklamave në tregun audiovisual.

<sup>5</sup> Ligji ndalon abuzimin me pozitën dominuese dhe jo pozitën dominuese.

<sup>6</sup> [http://ec.europa.eu/avpolicy/info\\_centre/a\\_z/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/avpolicy/info_centre/a_z/index_en.htm)